
REFORMS IN CHALLENGING INSPECTION INSTITUTIONS FOR THE SAFETY AND PROTECTION OF EMPLOYEES IN THE WORK PROCESS IN THE REPUBLIC OF KOSOVO

Lulzim Farizi

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, lulzim_farizi@hotmail.com

Abstract: Protection and security in the labor process is one of the key components for guaranteeing workers' rights in the labor market and a key element for guaranteeing basic rights in the labor process.

Care for the protection of workers' rights in the field of protection and security in the process of work is the main purpose of the services of the competent state authorities for the protection of the workers from the moment of conclusion of the employment agreement between the employer and the worker, but also for the struggle against the black economy as the main threat to workers' safety and health.

Overall reforms in state institutions also directly affect reforms in the institutions that are competent in the area of the labor market and in employment relations reports, so focusing in this direction is important to make radical reforms in order to protection of workers' rights in the process of job development and the rule of law in a state.

Reform of the competent institutions for inspection services should be done in terms of their professionalization, focusing in two directions: professionalization of inspection services and professionalization of the competent administration in this field.

Reforming inspection services is one of the major challenges that directly affects the respect for fundamental human freedoms and the rule of law for all employees and workers at the national level. Reforming transition countries is a challenge in itself and always leads to the application of law throughout the country, as a result of many determinant interrelated factors that prevent employers from fulfilling their obligations to workers in the field of occupational safety and health.

Keywords: reforms, inspection services, labor relations, occupational safety and health.

REFORMAT NË INSTITUCIONET ISNPEKTUESE SFIDË PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN E PUNËTORËVE NË PROCESIN E PUNËS NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Lulzim Farizi

Kolegji "BIZNESI" Prishtinë, Kosovë, lulzim_farizi@hotmail.com

Abstrakt: Mbrojtja dhe siguria në procesin e punës është një ndër komponentat kryesore për garantimin e të drejtave të punëtorëve në tregun e punës dhe element kryesor për garantimin e të drejtave elementare në procesin e punës.

Kujdesi për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në procesin e punës është qëllimi kryesor i organeve të shërbimeve të shtetit kompetente për mbrojtjen e të drejtave nga moment i lidhjes së marrveshjes për punë ndërmjet punëdhënësit dhe punëtorit, por edhe për luftën kundër ekonomisë së zezë si rezik kryesor për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve.

Reformat e përgjithshme në institucionet e shtetit ndikojnë drejtpërdrejtë edhe tek reformat në institucionet të cilat janë kompetente në fushën e tregut të punës dhe në raportet e marrdhënies së punës, andaj duke u fokusuar në këtë drejtim është e rëndësishme që të bëhen reforma rrënjësore me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve në procesin e zhvillimit të punës dhe sundimin e së drejtës në një shtet.

Reformimi i institucioneve kompetente për shërbimet inspektuese duhet të bëhet në drejtim të profesionalizimit të tyre edhe atë duke u fokusuar në dy drejtime: profesionalizimi i shërbimeve inspektuese dhe profesionalizimi i administratës kompetente për këtë fushë.

Reformimi i shërbimeve inspektuese paraqet një ndër sfidat kryesore që ndikon drejtpërdrejtë në respektimin e lirisë themelore të njeriut dhe sundimin e ligjit për të gjithë punëdhënësit dhe punëtorët në nivel vendi. Reformimi i vendeve në tranzicion paraqet sfidë në vete dhe gjithmonë çalon në aplikimin e ligjit në gjithë vendin, si pasojë e

shumë faktorëve determinant që ndërlidhen njëri me tjetri dhe pamundësojnë pëmbushjen e detyrimeve të punëdhënësve ndaj punëtorëve në fushën e mbrojtjes dhe shëndetit në punë.¹⁷⁶

Fjalët kyçe: reformat, shërbime inspektuese, marrëdhëniet e punës, mbrojtja dhe shëndeti në punë.

1. HYRJE

Inspektorati shtetëror i punës¹⁷⁷ është një ndër institucionet kryesore të shtetit që garanton mbrojtjen e të drejtave dhe detyrimeve të punëdhënësve dhe punëtorëve, respektivisht Inspektorati shtetëror i punës vepron dhe kryen kontroll ndaj subjekteve juridike në kuptim të mbykqyrjes së të njejtëve, se sa ata i respektojnë të drejtat e punëtorëve në fushën e marrëdhënieve të punës dhe në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në punë.

Inspektorati i punës është institucion më i rëndësishëm kompetent për kryerjen e kontrolleve inspektuese ndaj punëdhënësve për mbykqyrjen e të njejtëve se sa i respektojnë të drejtat e punëtorëve sipas normave juridike që i përkasin fushës së punës.¹⁷⁸

Inspektorati i punës gjithmonë duhet të fokusohet dhe të nënshtrohet reformimit dhe sëndërtimit të tij thelbësor në kapacitetet administrative dhe ato profesionale. Inspektorati shtetëror i punës duhet të jetë institucion profesional i cili duhet të bazohet dhe të mbindërtohet mbi kapacitetet profesionale të cilët duhet të jenë të gatshëm dhe të kenë kapacitete për aplikimin dhe zbatimin e ligjeve të fushës së punës.

Sundimi i së drejtës dhe respektimi i të drejtave të njeriut respektivisht të drejtat e punëtorëve tërësisht mvaret nga kapacitetet e shërbimeve inspektuese me përballimin me punëdhënësit, respektivisht që të mundësoj kryerjen e kontrolleve mbi gjithë punëdhënësit në të gjithë territorin e vendit.

Shërbimet inspektuese kompetente për fushën e punës duhet të bëjnë reformat në disa drejtime edhe atë: reformat legjislative, reformat politike, organizimi i brendshëm i shërbimit, ngritjen e resurseve profesionale administrative dhe resurseve inspektuese, sundimin e së drejtës, aplikimin e sistemit merit në ngritjen dhe avancimin e të punësuarve në institucionet inspektuese, luftën kundër korrupsionit, kampanjat për vetëdisimin e punëdhënësve dhe punëtorëve, bashkëpunimin e mirëfillt institucional, ndërtimin e një organi mbykqyrës ndaj institucioneve inspektuese të vendit, krijimin e databazës së përbashkët të institucioneve inspektuese kompetente në fushën e punës, etj.

2. PRINCIPET DHE HAPAT PËR NDRYSHIMET E SUKSESSHME

Principet për ndryshime nr. 1- Reformat legjislative: Rregullimi i fushës së mirëfillt legjislative është një ndër parakushti themelor për funksionimin e shtetit të drejtë dhe ligjor, mirëpo përskaaj kësaj në fushën e marrëdhënies së punës është shumë i rëndësishëm harmonizimi i të gjitha ligjeve vendore në fushën e punës dhe të mbrojtjes në punë me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Të gjitha vendet në tranzicion kanë probleme esenciale me krijimin dhe hartimin e një ligji të mirëfillt për marrëdhënie pune dhe për mbrojtje dhe shëndet në punë. Në vendet në tranzicion është shumë e rëndësishme që ndryshimet ligjore të bëhen konform plotikave aktuale të tregut të punës dhe mbi bazën e aplikimit të ligjit dhe sundimin e së drejtës. Përpilimi i një ligji të mirëfillt në fushën e marrëdhënies së punës dhe në fushën e mbrojtjes dhe shëndetit në punë paraqet esencën kryesore për garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe obligimeve të punëdhënësve dhe të punëtorëve.¹⁷⁹

Principet për ndryshime nr. 1- Reformat politike: Shërbimi inspektues i inspektoratit të punës duhet të reformohet sipas parimit të profesionalizimit të institucionit i cili institucion duhet që të menaxhohet nga persona profesional të cilët kanë njohuri të veçanta në fushën e punës dhe fushën e emergjencave dhe njëkohësisht të kenë vizion për ngritjen profesionale të shërbimit inspektues. Institucionet kompetente për fushën e marrëdhënies së punës dhe proceset që kanë të bëjnë në fushën e emergjencës respektivisht të mbrojtjes dhe shëndetit në punë, gjithmonë duhet tu nënshtrohen politikave reformuese me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale. Gjatë emërimit të menaxherit në organin kompetent në fjalë duhet të kihet parasysh që të emërohet person i kualifikuar i cili ka njohuri në fushën përkatëse. Në bazë të ligjit duhet të precizohen saktësisht kushtet të cilët duhet ti plotësoj person i cili do të menaxhojë me inspektoratin, respektivisht personi i cili do të menaxhojë duhet të jetë profesionist në fushën e punës edhe atë gjatë selektimit të ketë dy kritere bazë: personi të ketë kualifikimin profesional në fushën përkatëse në marrëdhënien e punës ose fushën e mbrojtjes dhe shëndetit në punë dhe personi të zgjedhet nga ana e

¹⁷⁶ Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-161

¹⁷⁷ <https://ip.rks-gov.net/> qasur me datë 12.10.2019

¹⁷⁸ Ligji i punës së Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-212

¹⁷⁹ Mircev, Dimitar. Partizimi i administratës publike si problem themelor i zhvillimit demokratik të shtetit. UEJL, Tetovë, (2008)

punëtorëve të cilët punëojnë dhe veprojnë në institucionin përkatës. Këto dy elemente pamundësojnë politizimin dhe ndikimin nga i njejtë dhe nga ana tjetër ndikon drejtpërdrejt në profesionalizimin e tij.¹⁸⁰

Principet për ndryshime nr. 3- Organizimi i brendshëm i shërbimit inspektues: Faktorët janë të ndërlidhur mes vete dhe ndikojnë reciprokisht si një zinxhir i pa shkëputur, nga se efektet dhe (mos)rezultatet mvaren nga ndërveprimi i faktorëve të përgjithshëm. Faktori i organizimit të brendshëm të institucionit përkatës inspektues dhe sistematizimi i vendeve të punës kryesisht mvaret nga kapaciteti dhe vizioni i personit menaxhues, nga se varësisht nga aftësit dhe njohurit e tij në fushën përkatëse mvaren edhe ndikimi i tij i drejtpërdrejt në organizimin e punës dhe më pastaj mvaret edhe rezultati në përgjithësi. Ndikimi politik nëpër institucionet përkatëse, veçanërisht në propozimin dhe vendosjen e personit në pozitën menaxhuese shpesh herë ndikon drejtpërdrejt edhe në mosfunksionimin e mirëfillt të institucioneve konkrete kompetente në fushën e zhvillimit të marrdhënies së punës që ka të bëjë me respektimin dhe garantimin e të drejtave elementare të punëtorëve, e veçanërisht në mbrojtjen dhe shëndetin e tyre në procesin e punës. Eliminimi i anomalive në organizimin dhe funksionimin e institucionit përkatës mund të bëhet vetëm nëse gjatë selektimit dhe vendosjes në pozicionin menaxherial të përzgjedhet kandidati i cili i plotëson kushtet konform metodologjisë të cilën e përdorin vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian.¹⁸¹ Përzgjedhja e kandidatëve si në pozicionin e menaxherit general, e deri tek udhëheqësit e seksioneve dhe repartëve të bëhet sipas nevojave dhe standardeve përkatëse, e jo sipas interesave personale me synim kryesor dhe primar për të shikuar benefitet personale. Shërbimet inspektuese gjithmonë duhet të fokusohen që të investojnë më së shumti në kapacitetet inspektuese se sa në kapacitetet tekniko-administrative. Shtylla kryesore e këtyrë shërbimeve janë resurset njerzore të profesionalizuara (inspektorët) në kryerjen e mbykqyrjeve ndaj subjekteve juridike për përmbushjen e standardeve minimale për garantimin e mbrojtjes dhe shëndetit të punëtorëve në vendin e punës.¹⁸²

Principet për ndryshime nr. 4- Ngritja e kapaciteteve profesionale humane: Tranzicioni ka ndikuar drejtpërdrejt në investimin e gabuar dhe joprofesional të kuadrit njerzor në procesin e krijimit të marrdhënive të punës më të njejtë, respektivisht institucionet përkatëse për kryerjen e mbykqyrjeve inspektuese janë stërmbyshur me persona të pakualifikuar dhe ata drejtpërdrejt ndikojnë në moskryerjen e punës në mënyrë profesionale.

Inspektorati i punës dhe inspektoratet e tjera kompetente për mbykqyrjen e subjekteve juridike për përmbushjen e standardeve minimale për procesin e punës e sidomos të përmbushjes së standardeve për mbrojtjen dhe shëndetin në punë duhet që gjatë punësimit të kuadrit të kenë për kriter bazë kapacitetet profesionale dhe jo ndikimet politike. Raportet e progresit të Bashkimit Evropian gjithmonë vërejtje kryesore e kanë ndikimin politik mbi administratën shtetërore që drejtpërdrejt ndikon në mosprofesionalizimin e saj. Institucioni i inspektoratit të punës i Republikës së Kosovës ballafaqohet me mungesë të kuadrit profesional dhe ati administrative, që paraqet hendikep kryesor për mospasjen e kapaciteteve të këti institucioni në kryerjen e kontroleve tek të gjitha subjektet në nivel shtetëri, që njëkohësisht u jep hapsir subjekteve juridike (kompanive) të mos përmbushin standardet e kërkuara sipas normave juridike të vendit për respektimin e të drejtave të punëtorëve në procesin e zhvillimit të punës si në fushë e marrdhënive të punës ashtu edhe në fushën e mbrojtjes dhe shëndetit në punë.

Mungesa e kuadrit profesional pamundëson kryerjen e kontroleve brenda vitit në të gjitha subjektet juridike që në një farë forme pamundëson mbykqyrjen e kompanive se sa ato i plotësojnë kushtet ndaj punëtorëve në procesin e zhvillimit të punës. Mungesa e inspektorëve ndikon drejtpërdrejt edhe në aplikimin e legjislacionit të vendit, e sidomos të ligjit për mbrojtje dhe shëndet në punë që ka të bëjë në përmbushjen e standardeve minimale për ofrimin e masave mbrojtëse të punëtorëve në procesin e zhvillimit të përcesit të punës.

Mungesa e kapaciteteve njerzore profesionale (inspektorëve) në fushën e mbrojtjes dhe shëndetit në punë pamundeson që të bëhet shtypje më e madhe ndaj punëdhënësve në ndërmarjen e hapave konkret për vlerësimin e rizikut të punëtorëve në vendin e punës dhe edukimin e tyre në aspektin e përgaditjes së tyre për tu mbrojtur nga lëndimet dhe aksidentet në vendin e punës si pasoj e punimit me mjetet e punës.

Inspektorati i punës së Republikës së Kosovës duhet të ketë kujdes në procesin e punësimit të punëtorëve të ri, sidomos gjatë procesit të punësimit rëndësi të madhe ti japë vendeve vakante ose qyteteve të cilat kanë më tepër subjekte juridike me qëllim që të mbulohet hapsira me numër të mjaftueshëm të inspektorëve.

Principet për ndryshime nr. 5- Sundimi i së drejtës: sundimi i së drejtës dhe të sistemit të së drejtës është një ndër faktorët kyç nga i cili mvaret respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe respektimit të të drejtave

¹⁸⁰ Elezi, Zemri. Reformat e administratës publike në Maqedoni konform standardeve evropiane. UEJL, Tetovë, (2008)

¹⁸¹ Ibrahim, Bedredin. Reformat e administratës publike dhe anëtarësimi në Bashkimin Evropian. UEJL, Tetovë, (2008)

¹⁸² https://ip.rks-gov.net/?page_id=2678 qasur me dt. 15.10.2019

të punëtorëve në veçanti.¹⁸³ Procesi i tranzicionit dhe mungesa e sovranitetit i shërbimit inspektues në gjithë territorin e vendit lë hapsirë dhe mundëson shkeljen e të drejtave të punëtorëve në fushën e punës. Mos sundimin e së drejtës mundëson që punëdhënësi të angazhon punëtorë pa krijuar marrdhënie të rregullt të punës sipas legjislacionit në fuqi dhe mundëson që punëdhënësi të mos ndërmer masa të sigurisë të nevojshme për zhvillimin e procesit të punës të cilët drejtëpërdrejt ndikojnë mbi shëndetin dhe sigurinë e punëtorit.

Sundimi i së drejtës, sundimi i ligjit dhe sundimi i institucioneve janë një nga faktorët kyç për zvoglimin e ekonomisë së zezë dhe paraqesin faktorin themelor që ndikon drejtëpërdrejt detyrimin e punëdhënësit në ndërmarrjen dhe plotësimin e kushteve që kanë të bëjnë me mbarvajtjen e procesit të punës në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Shërbimet inspektuese duhet që ti ndërmarin të gjitha masat, dhe të shfrytëzojnë të gjithë kapacitetet e tyre pa diskriminim të bëjnë mbykqyrje inspektuese në të gjithë territorin e shtetit.

Principet për ndryshime nr. 6- Sistemi merit: Një nga sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen të gjitha institucionet në përgjithësi, e veçanërisht shërbimet inspektuese kompetente për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve në procesin e punës janë ndikimi politik në procesin e punësimit dhe në procesin e avancimit në pozicionet menaxheriale, që nga menaxheri kryesor e deri tek udhëheqësit e seksioneve dhe reparteve. Edhe përkaj rekmandimeve të Bashkimit Evropian se duhet që të departizohet administrata publike dhe ajo shtetërore, që drejtëpërdrejt nënkupton edhe shërbimet inspektuese të cilat bien nën ombrellën e organeve të pushtetit shtetëror, respektivisht punëtorët në administratën shtetërore, të cilët ndikime politike ndikojnë drejtëpërdrejt në krijimin e politikave institucionale të shërbimeve inspektuese dhe që ndikojnë në përgjithësi negativisht në shërbimet inspektuese si në krijimin e politikave ashtu edhe në zbatimin e tyre.¹⁸⁴

Ndikimet politike në procesin e punësimit të kuadrit profesional po ashtu edhe të ati administrativ drejtëpërdrejt më pastaj ndikon në kualitetin e kryerjes së mbykqyrjeve inspektuese, respektivisht inspektori gjatë kryerjes së mbykqyrjes nuk konstaton gjendjen reale faktike për arsye të ndikimeve politike, të cilat ndikime politike mund të jenë në relacion mes punëdhënësit, personit politik që ka ndikuar në punësimin e kuadrit të inspektorit dhe vet inspektorit.

Në afat sa më të shkurtë dhe urgjent duhet të bëhet ndërprerja e ndikimeve partiake dhe politike në procesin e punësimit të nëpunësve shtetëror e veçanërisht të personave të cilët do të punësohen dhe do të avancohen në shërbimet inspektuese kompetente për mbykqyrjen e punëdhënësve për përmbushjen e kushteve elementare për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve në zhvillimin e procesit të punës.¹⁸⁵

Principet për ndryshime nr. 7- Korrupsioni:¹⁸⁶ Korrupsioni paraqet një nga sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen shtetet në përgjithësi dhe Republika e Kosovës në veçanti e cila gjithmonë kritikohen nga institucionet ndërkombëtare relevante për vlerësimin e nivelit të korrupsionit në administratën shtetërore. Vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare dhe organeve të Bashkimit Evropian janë se Republika e Kosovës si vend në tranzicion ballafaqohet më nivelin e lartë të korrupsionit në administratën shtetërore që e njejta vlen edhe për shërbimet inspektuese.¹⁸⁷ Pasojat e korrupsionit i ndjenjë më tepër punëtorët nga se ndikimi nga ky element ndaj inspektorit gjatë kryerjes së kontrollit ndikon drejtëpërdrejt në shkeljen e të drejtave të punëtorit, si pasoj e asaj se punëdhënësi nëpërmjet korrupsionit ndikon në konstatimin e gjendjes faktike reale tek punëdhënësi duke anuar nga ana e punëdhënësit duke shkelur drejtëpërdrejt të drejtat e punëtorëve. Institucionet përkatëse kundër korrupsionit duhet të ndërmarrin masa konkrete në parandalimin e kësaj dukurie negative që rënon institucionet shtetërore inspektuese dhe mundëson shkeljen e drejtëpërdrejt të të drejtave të punëtorëve.¹⁸⁸

3. HAPAT PËR NDRYSHIM TË SUKSESSHËM

Sfidat më të mëdha për Republikën e Kosovës si shtet në tranzicion do të jenë: harmonizimi i legjislaturës vendore me atë evropiane, mungesa e kuadrit dhe kuadrit profesional në shërbimet inspektuese, aplikimi i merit sistemit në procesin e punësimit dhe ngritjes në karrierë, diskrepanca në zbatimin e ligjeve mes sektorit publik dhe ati privat, kryerja e mbykqyrjeve në të gjitha subjektet juridike, përgjegjësia e shërbimeve inspektuese, kontrolli i shërbimeve

¹⁸³ Elezi, Zemri. Reformat e administratës publike në Maqedoni konform standardeve evropiane. UEJL, Tetovë, (2008)

¹⁸⁴ Mircev, Dimitar. Partizimi i administratës publike si problem themelor i zhvillimit demokratik të shtetit. UEJL, Tetovë, (2008)

¹⁸⁵ http://aa.mk/EBStorage/Files/poglavje17_AL.pdf qasja me datë 15.09.2019

¹⁸⁶ Kambovski, Vllado. Korrupsioni. Shkup, (2002)

¹⁸⁷ Abdullahi, Jonuz. Ndryshimet sociale dhe korrupsioni në vendet në tranzicion. UEJL, Tetovë, (2008)

¹⁸⁸ Shasivari, Jeton. Korrupsioni i personave zyrtarë si kërcënim serioz për shtetin e së drejtës në Maqedoni. UEJL, Tetovë, (2008),

inspektuese nga një organ i veçant, krijimi i databazës mbi kryerjen e mbykqyrjeve inspektuese, ndaraja e partisë nga shteti, etj

4. KONKLuzionET

Reformat në administratën shtetërore paraqesin një nga sfidat kryesore për Republikën e Kosovës në procesin e euro-integritimit, e veçanërisht profesionalizimin e saj në fushën e shërbimeve inspektuese. Reformimi dhe profesionalizimi i shërbimeve inspektuese nuk nënkupton vetëm sjelljen dhe harmonizimin e legjislacionit vendor me atë të Bashkimit Evropian, por nënkupton harmonizimin dhe zbatimin e tij në praktikë konform standardeve të Unionit që të jetë i barabart edhe për punëdhënësit edhe për punëtorit sa i përket fushës së marrdhënies së punës.

LITERATURA

- Abdullai, J., (2008). *Ndryshimet sociale dhe korrupsioni në vendet në tranzicion*. UEJL, Tetovë.
- Elezi, Z., (2008). *Reformat e administratës publike në Maqedoni konform standardeve evropiane*. UEJL, Tetovë.
- Ibrahimi, B., (2008). *Reformat e administratës publike dhe anëtarësimi në Bashkimin Evropian*. UEJL, Tetovë.
- Kambovski, V., (2002). *Korrupsioni*. Shkup.
- Mircev, D., (2008). *Partizimi i administratës publikesi problem themelor i zhvillimit demokratik të shtetit*. UEJL, Tetovë.
- Shasivari, J., (2008). *Korrupsioni i personave zyrtarë si kërcënim serioz për shtetin e së drejtës në Maqedoni*. UEJL, Tetovë.